



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 14450 Prot

Lezhë, më 24 / 8 /2022

**NJOFTIM**

**Për thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Lezhë**

**Drejtuar:** Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Lezhë

**Për dijeni:** Kryetarit të Bashkisë Lezhë

**Për dijeni:** Prefektit të Qarkut Lezhë

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen Vendore", neni 53 pika 2, pika 4, neni 56, pika 2 shkronja "a" dhe në Rregulloren e Këshillit të Bashkisë Lezhë, e miratuar me VKB nr. 54, datë 28.04.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë me shkresën nr.prot. 358/1, datë 15.05.2020, njoftoj thirrjen e **mbledhjes së radhës (Gusht 2022)** të Këshillit Bashkiak Lezhë, ditën e **hënë, në datën 29.08.2022, në orën 13:00, në sallën e Qendrës Kulturore të Fëmijëve, me këtë**

**REND DITE:**

1. Projekt-Vendim "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Korrik 2022"
2. Projekt-Vendim "Për miratimin e marrëveshjes dhe pjesëmarrjen e Bashkisë Lezhë në subjekte me kompetenca të përbashkëta me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura"
3. Projekt-Vendim "Për përdorimin e fondit të kontingjencës, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuaranë buxhetin e vitit 2022"
4. Projekt-Vendim "Për heqjen nga kontabiliteti i detyrimeve të prapambetura që nuk justifikohen me dokumentacion financiar dhe ligjor"
5. Projekt-Vendim "Për miratimin e listës së familjeve që përfitojnë subvencionimin e interesave të kredisë për vitin 2022"
6. Projekt-Vendim "Për miratimin e dorëheqjeve të disa kryetarëve të fshatrave"
7. Interpelancë me Kryetarin e Bashkisë në lidhje me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore kërkuar nga këshilltari Agostin Marku
8. Të ndryshme

**Grafiku i mbledhjeve të komisioneve:**

Nr	Komisioni	Dita	Data	Ora
1	Komisioni i Mirëqenies Sociale	E premte	26.08.2022	10:00
2	Komisioni Juridik	E premte	26.08.2022	10:15
3	Komisioni i Ekonomisë dhe Financave	E premte	26.08.2022	10:30
4	Komisioni i Shërbimeve Publike	E premte	26.08.2022	10:45

